

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ELEKTRA - CHARGE" SHPK

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia

Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot me date **04.03.2025**, ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne Ortakët e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **" ELEKTRA - CHARGE "SHPK**, formulojmë Statutin e saj, si me poshte vijon,

Ortakët e shoqerise jane:


1. **ASLLAN DËRVISHI**, i lindur ne Tiranë, i datelindjes **06.04.1983**, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me Leternjoftim **ID nr. 027699299 dhe nr.personal I30406191P**.
2. **GRIDA ISUFI** e lindur në Kavajë, e datëlindjes **26.06.1990**, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me Leternjoftim **ID nr. 038121355 dhe nr.personal J05626125U**.

Neni 2: Objekti

Shoqeria do te ushtroje veprimtarin si vijon:

Karikim i makinave elektrike.

- Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te cdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise e cila nuk ndalohej me ligj(sipas



nenit 7 te Ligjit nr.990 I ,dt.14.04-08).

Neni 3: Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.

Neni4:Selia

Selia e shoqerise do te jete:

**Tirane , Lagja Nr.13,Kodra e Diellit,Rruga Rexhep Pinari,Zona kadastrale
3992,Nr.Pasurisë 52/70+4-4.**

Kreu II

Kapitali i regjistruar

Neni 5:Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali i shoqerise eshte **100000 (njëqind mijë)** Leke, i ndare ne **2 kuota**.

Kontributi i ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte vlerësuar sipas te dhenave te meposhtme:


ASLLAN DËRVISHI, eshte zoterues i 1 kuote, me vlere 50.000 leke, me 50% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise.

GRIDA ISUFI, eshte zoteruese e 1 kuote, me vlere 50.000 leke, me 50% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise

Neni 6: Pagesa e kuotave

Administratoret mund t'i kerkojne ortakeve pagimin e kontributeve ne para te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre.

Ne rast te mos shlyerjes se kontributeve, sipas percaktimit te administratorit, personi pergjegjes do te paguaje nje kamate vonese mbi shumen e papaguar me interes prej 4% ne vit.



Neni 7: Kalimi i kuotave

Kalimi i kuotave dhe i te drejtave qe rrjedhin prej tyre, mund te behet me kontrate shitblerje, me dhurim, me trashegimi ose me cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Neni 8: Zmadhimi e zvogelimi i kapitalit themeltar

Asambleja e Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar te votave.

Kreu III

Asambleja e pergjithshme

Neni 9: Te drejtat dhe detyrimet

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) ndryshimet e statutit,
- c) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
- d) emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar,
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- f) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit,
- g) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,
- j) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese,
- k) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.



Neni 10: Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- a) Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori te pakten 2 here ne vit, per te miratuar perkatesisht bilancin vjetor te mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues.
- b) Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje shkrese derguar cdo ortaku me poste te zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen.
- c) Ortaket, qe zoterojne te pakten 5% te kapitalit te regjistruar kane te drejte te therrasin mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme nepermjet administratorit ose edhe pa ndermjetesimin e tij.

Neni 11: Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

- a) Mbledhja e Asamblese eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 30% te aksioneve, per te vendosur per ceshtje te zakonshme. Ne kete rast vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga shumica e votave te ortakeve pjese marres.
- b) Mbledhja e Asamblese, per te vendosur per ceshtje te vecanta si: ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqerise, eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 50% te kuotave. Ne kete rast vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga jo me pak se tre te katertat e kuotave te ortakeve pjesmarres, (e cilesuar ne kete statut si "shumice e kualifikuar").
- c) Mbledhja e Asamblese drejtohet nga administratori nese eshte e thirrur prej tij. Nese Asambleja e Pergjithshme eshte thirrur nga pakica, atehere ajo kryesohet nga njeri nga ortaket e zgjedhur nga pjesemarrësit ne ate mbledhje.
- d) Administratori pavaresisht se nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marri fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme.



Neni 12: Votat e Pjesemarresve

- a) Cdo ortak ka te drejta vote ne perpjesetim me vleren nominale te kuotes se tij.
- b) Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet, qe kane te bejne me kuotat, qe ai disponon.

Neni 13: Emerimi i Administratorit

- a) Administrimi si dhe perfaqesimi i shoqerise i besohen nje Administratori te vetem qe mund edhe te mos jete ortak.
- b) Administratori emerohet **per 5- vite** nga regjistrimi i shoqerise prane QKB-ne, me te drejte ripërteritje, me perjashtim doreheqje apo shkarkimi nga ana Asamblese.
- c) Detyra e Administratorit te vetem i ngarkohet **Znj. GRIDA ISUFI**, te cilës i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit e shoqerise.
- d) Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje ne cdo kohe Administratorin nga detyra, me shumice te zakonshme votash, me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zotërojnë me shume se 30% te kuotave .

Neni 14: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet:

- a. te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme,
- b. te perfaqesoje shoqerine,
- c. te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise,
- d. te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor parashikues per vitin e ardhshem, per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme, brenda dates 20 tetore te vitit paraardhes.



- e. te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor te mbyllur, per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme, brenda dates 20 mars te vitit te ardhshem dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara Asambles se Pergjithshme per miratim,
- f. te krijojte nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,
- g. te kryejne regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise,
- h. te raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare,
- i. te kryejte detyra te tjera, te percaktuara ne ligj dhe statut.

Neni 15: Mbledhjet e Administratorit

Administratori kujdeset qe ne libra te posacem te mbaje proces verbalet e te gjitha takimeve te kryera nga ai, si dhe te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

Kreu VI

Shperndarja e fitimit vjetor te shoqerise

Neni 16: Shperndarja e fitimit vjetor

- a) Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.
- b) Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shpemdaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.
- c) Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.



Kreu VII

Prishja dhe njoftimet

Neni 17: Prishja dhe likuidimi

- a) Në rast të likuidimit të shoqërise, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.
- b) Me vendimin e posaçëm të Asamblese së Përgjithshme, të marre me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërise, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërise ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Neni 18: Ftesa për kreditorët

Likuiduesit duhet të ftojë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

Neni 19: Përfundimi i likuidimit


- a) Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon regjistrimin e shoqërise.
- b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas regjistrimit të shoqërise nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Neni 20: Dispozitat e fundit

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij statuti. Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislati në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Ortakët

Grinda Isufi



AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" ELEKTRA - CHARGE "SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot me date 04.03.2025, ne të nënshkruarit:

1. **ASLLAN DËRVISHI**, i lindur ne Tiranë, i datelindjes **06.04.1983**, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me Leternjoftim **ID nr. 027699299** dhe nr.personal **I30406191P**.
2. **GRIDA ISUFI** e lindur në Kavajë, e datëlindjes **26.06.1990**, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me Leternjoftim **ID nr 038121355** dhe nr.personal **J05626125U**.

3.

Themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin
" ELEKTRA - CHARGE "SHPK.

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Neni 2: Selia

Selia e shoqerise do te jete:



Tirane , Lagja Nr.13,Kodra e Diellit,Rruga Rexhep Pinari,Zona kadastrale
3992,Nr.Pasurisë 52/70+4-4.

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithë territorin shqiptare.

Neni 3: Objekti

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine si vijon: **Karikim te makinave elektrike.**

- Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te cdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 te Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

Neni 4: Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqerise eshte **100.000 (njqind mije)** Leke, i ndare ne 2 kuota.

Kontributi i ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte vleresuar sipas te dhenave te meposhtme:

ASLLAN DËRVISHI, eshte zoteruese i 1 kuote, me vlere 50.000 leke, me 50% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise.

GRIDA ISUFI, eshte zoteruese i 1 kuote, me vlere 50.000 leke, me 50% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise.



Neni 6: Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

- (-) Asambleja e Pergjithshme.
- 4. (-) Administratore e shoqerise do te jete **GRIDA ISUFI** e lindur në Kavajë, e datëlindjes **26.06.1990**,madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me Leternjoftim **ID nr. 038121355** dhe nr.personal **J05626125U**, per nje periudhe **5 vjecare** me te drejte riemerimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8:Dispozitat e fundit

Shoqeria respekton ligjin dhe statutin qe eshte pjese e pandare e ketij akti.
Per cdo gje tjeter, qe nuk eshte shkruar shprehimisht ne kete statut, zbatohet legjislacioni ne fuqi per shoqerite tregtare, per QKB-ne si dhe cdo ligj tjeter mbi veprimtarine e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar.

Emri dhe nenshkrimi i Ortakeve te Shoqerise

Grinda Isufi


Hasan Demiri
